

RELACION

Asamblesë Kombëtare

Mbi auditimin e ushtruar nga grupi I Kontrollit të Lartë të Shtetit

Të nderuar zotërinj

Si jeni venë në dijeni, me kërkesë të Presidentit të USSH-së, nga data 16.02 deri 08.03.2016, grupi audit I Kontrollit të Lartë të Shtetit ka ushtruar kontroll gjate muajit shkurt-mars 2016 sipas një tematike të miratuar. Auditimi I kushtoi vemendje të posaçme çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko – financiare, për fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti I Shtetit në formën e financimit fillestar të këtij institucioni.

Objektivi kryesor për këtë auditim ka qënë përputhshmëria me aktet ligjore dhe nënligjore I veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësimi për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit konform dispozitave ligjore, realizimi sipas klasifikimit ekonomik si dhe kompetencat e përdorimit të këtyre fondeve.

Nga kontrolli nuk rezultoi abuzim apo dëm ekonomik në administrimin e fondeve, për blerjet e kryera janë zbatuar procedurat standarte të prokurimit, me procedura online në sistemin e prokurimeve të APP-së, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Llogaritjet e shpenzimeve për paga janë kryer në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Arkëtimet e të ardhurave janë kryer vetëm nepermjet sistemit bankar. Zbatimi i buxhetit është bërë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe sipas klasifikimit ekonomik e buxhetor të miratuar nga Ministria e Financave.

Në përfundim të auditimit, janë lënë rekomandime që të merren masa organizative për eliminimin e disa mangësive të konstatuara prej tyre. (bashkëlidhur materialit)

Rekomandimet :

1. Ndryshimi në statut I nenit 8 “Buxheti” dhe sjelljen e tij në përputhje me ligjin nr.127 datë 02.10.2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.
2. Në zbatim të Ligjit, Buxheti duhet të miratohet në Asamblesë Kombëtare dhe jo në Këshillin Kombëtar.
3. Të merren masat për programimin e të ardhurave dhe burimeve të krijimit të tyre si dhe programimin e shpenzimeve sipas zërave dhe prioriteteve me relacion shpjegues.
4. Të bëhet analiza periodike për realizimin e buxhetit, mangësitë e konstatuara dhe faktorët që kanë ndikuar në mosrealizim me qëllim të hartimit të një buxheti sa më real për periudhat në vazhdimësi.
5. Blerjet e realizuara të shoqërohen me kërkesa nga sektorët për hartimin e kërkesave sa më reale.

Mbi rekomandimet e lëna nga KLSH, është hartuar një program masash organizative për përmirësimin e punës së USSH-së të cilat kanë filluar të zbatohen dhe do të mbahen parasysht gjatë veprimtarisë së USSH-së në vazhdimësi. (bashkëlidhur materialit)

1. **Rekomandimi I pare** : Ndryshimi në statut është përcaktuar që do të bëhet në mbledhjen më të afërt të Këshillit Kombëtar .
Në mbledhjen e sotme do të miratohen ndryshimet në statut, midis të cilave dhe neni 8 I tij “ Buxheti”, të cilën ju ftoj ta miratoni.
2. **Rekomandimi I dytë**: Miratimi I buxhetit në Asamblenë Kombëtare është realizuar me mbledhjen e dates 20.04.2016, ku u miratua buxheti faktik I vitit 2015 dhe Buxheti I vitit 2016. Buxheti I vitit 2015 ishte miratuar në Këshillin Kombëtar pasi kështu ishte përcaktuar në statutin e miratuar nga Këshilli.
3. **Rekomandimi I tretë**: Planifikimi I të ardhurave dhe shpenzimeve është I detajuar sipas burimeve të krijimit dhe destinacionit të përdorimit të tyre sipas klasifikimit ekonomik. Në këtë mënyrë ishte planifikuar viti 2015, megjithese plani ishte apriori pasi nuk kishte përvojë të trashëguar dhe administrata në muajin qershor sapo kishte filluar të organizohej . Në baze të planit të shpenzimeve të planifikuar për vitin 2015 ishte hartuar regjistri I prokurimeve publike I cili ishte depozituar në Agjensinë e Prokurimit Publik. Në këtë mënyrë është vepruar për planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2016.
4. **Rekomandimi I katërt**: Analiza vjetore për realizimin e buxhetit është realizuar në momentin që kemi hartuar evidence e realizimit të tij si dhe regjistrin e realizimit të prokurimeve publike të dorzuar në APP. Megjithatë ky rekomandim është realizuar me analizën 6- mujore të vitit 2016 dhe në fund të vitit do të bëhet analiza vjetore, si pjese e analizës vjetore të USSH-së.
5. **Rekomandimi I pestë**: Për vitin 2015 janë realizuar blerje që kanë patur qëllim krijimin e kushteve të punës së administrates dhe paraqiteshin nga stafi drejtues I Urdhrit, I cili ka qenë pjesë e komisionit të blerjes. Në këto kushte nuk ishte evidentuar kërkesa e vacantë por si pjesë e dokumentacionit të njësisë së prokurimit.
Megjithatë për vitin 2016 rekomandimi është zbatuar, pasi blerjet bëhen me kërkesa nga sektorët apo rajonet dhe sipas procedurave të prokurimit, pamvarësisht se fondet nuk janë të buxhetit të shtetit.

Më datën 05.11.2016, grupi audit I KLSH-së auditoi zbatimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e mëtejshëm të punës. Nga auditimi I kryer rezultoi zbatimi I të pestë rekomandimeve të lëna , të dhëna që paraqiten në tableën si vijon:

Rekomandime	Propozuar	Realizuar	Ne process	Nuk janë realizuar(Nuk meren ne konsiderate
Masa organizative	5	5	0	0
Masa zhdëmtimi	0	0	0	0
Masa administrative	0	0	0	0
Masa disiplinore	0	0	0	0
Shuma	5	5	0	0

Detyrat e lëna nga grupi audit I KLSH-së dhe program I masave të hartuar nga Aparati Qendror do të jenë në fokus të punës sonë në vazhdimësi.

Ju faleminderit!

**P/SEKTORIT EKONOMIK
DHE ADMINISTRATES**

Natasha DHRAMI